



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:117395

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05627684

Rev.nr.492/2023

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Beshir Islami dhe Rrustem Thaqi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A (R) K.,i nga, Komuna S., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura "Judex" sh.p.k., me seli në Prishtinë, kundër të paditurve Sh(Jahir) K, I(S) K dhe H (A) K., të gjithë nga ..., Komuna S, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Sehad Haliti, avokat nga Suhareka, me objekt kontesti shuarje e të drejtës së servitutit, duke vendosur sipas revizionit të autorizuarit të paditësit, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.6153/19 të datës 10.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet i pathemeltë revizioni i të autorizuarit të paditësit A (R) K nga, Komuna S., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.6153/19 të datës 10.10.2023.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, C.nr.355/2015 të datës 28.10.2019, në pikën I të dispozitivit është refuzuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit në tërsi si e pabazuar, përmes së cilës ka kërkuar që të aprovet padia e paditësit A(.R) .K nga fshati

...., Komuna S., dhe shuhet e drejta e servitutit për të paditurit Sh. J. K, I. S. K., dhe H.A.K., që të gjithë nga ... Komuna S., të rrugë kalimit e cila kalon nëpër ngastrën kadastrale nr....., në vendin e quajtur “K/D”., ZK B., e cila rrugë fillon nga rruga publike nr., në hyrje të ngastrës së paditësit, pika 101-102 ku gjerësia është 12.80m dhe përfundon në pikën 130-131 ku gjerësia e saj është 3.10m, e që kap sipërfaqe prej 605 m², e cila pastaj vazhdon në ngastrën kadastrale nr. pronë e këtu të paditurve. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore i bartë pala paditëse dhe atë: për 6 seanca të mbajtura nga 202 euro sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, shumën e përgjithshme prej 1212 €, të gjitha këto mjete detyrohet pala paditëse ti paguaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditësit me aktgjykimin Ac.nr.6153/19 të datës 10.10.2023, ka vendosur që të refuzoj si të pabazuar ankesën e paditësit A(R)K nga, Komuna S., ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, C.nr.355/2015 të datës 28.10.2019.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë i autorizuari i palës paditëse në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovoj revizionin e paditësit, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ti ndryshoj, ashtu që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, ose aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta ti anuloj dhe lëndën t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

I autorizuari i të paditurve ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditësit, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës revizionin e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe të vërtetoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të autorizuari të paditësit është i pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A. K., nga fshati B., Komuna S., më datë 22.10.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për shuarjen e të drejtës së servitutit, kundër të paditurve Sh (J) K, I(S) K dhe H (A) K., gjithë nga, Komuna S.,

Shuarja e të drejtës së servitutit është kërkuar mbi bazën e asaj që të paditurit mund të kalojnë në paluajtshmërinë e tyre përmes ngastrës kadastrale ..., e regjistruar si P.sh. Rrugë e pa kategorizuar, si dhe fakti që rruga ekzistuese kalon në mes të pasurisë së paditësit dhe ia vështirëson shfrytëzimin e saj, andaj është vlerësuar se janë plotësuar kushtet për shuarje të servitutit ashtu siç është përcaktuar me nenin 260 paragrafi 2 të LPDTS.

Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të administruara ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit, me vlerësim se të paditurit kalojnë nëpër ngastrën kadastrale nr. 1672, pronë e paditësit, dhe se të njëjtën e kanë shfrytëzuar me vite të tëra, ndërsa nuk ka rrugë tjetër që të qon tek prona e të paditurve dhe personat e tretë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se bazuar në nenin 260 paragrafi 1 dhe 2 të LPDTS, deklaratat e palëve ndërgjyqëse, dëshmitarëve dhe ekspertiza e gjeodezisë, rezulton se nuk është plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për shuarjen e të drejtës së servitutit, andaj mbi këtë bazë është refuzuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata e Apelit duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditësit ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore për gjendjen faktike, me ç'rast ka konstatuar se nga provat e administruara të cilat janë propozuar nga palët ndërgjyqësore, e të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, përfshirë edhe marrjen e provës me këqyrjen e gjykatës në vend me ndihmën e ekspertit të gjeodezisë, si dhe me dëgjimin e palëve dhe dëshmitarit, rezulton se hetimi i çështjes në këtë rast është bërë në masë të mjaftueshme sepse gjykata ka arritur të konstatojë gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë për rrethanat që janë me rëndësi në këtë rast dhe atë rrethanën nëse janë plotësuar kushtet e parapara me dispozita ligjore për shuarjen e servitutit.

Në raport me të drejtën materiale, Gjykata e Apelit vendimin e saj e ka mbështetur në nenin 260 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, me vlerësim se nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, e duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje

juridike, dhe se drejtë ka konstatuar se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me dispozita ligjore për shuarjen e servitutit.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e dhënë në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi i kundërshtuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 215 të LPK-së.

I autorizuari i paditësit në revizionin e paraqitur pretendon se aktgjykimi i shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK-së. Gjykata Supreme vlerëson se pretendimet e tilla janë të pa bazuara, kjo pasi që Gjykata e Apelit ka adresuar në aktgjykimin e saj pretendimet thelbësore ankimore të ngritura nga pala paditëse në ankesë, përkatësisht ka arsyetuar se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë në dispozitiv dhe me arsyet e dhëna, ndërsa janë dhënë arsye për të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me çështjen objekt shqyrtimi. Pra nga aktgjykimet e instancave më të ulëta shihet se është adresuar kërkesa e paditësit dhe në këtë mënyrë janë dhënë arsye të qarta për faktet vendimtare në lidhje me kërkesën për shuarjen e të drejtës së servitutit. Gjykatat përmes fakteve të identifikuara kanë argumentuar qartë se të paditurit janë duke e shfrytëzuar paluajtshmërinë e paditësit ngastrën kadastrale ..., (pronën shërbyese), si rrugë për të kaluar në paluajtshmërinë e tyre ngastra kadastrale, (prona dmominuse) dhe se këtë gjë janë duke e bërë me vite të tëra. Për faktet e tilla gjykatat kanë dhënë arsye të qarta, dhe atë bazuar në deklaratat e palëve ndërgjyqëse, deklaratat e dëshmitarëve dhe ekspertiza e ekspertit të gjeodezisë, përfshirë edhe deklaratën e ekspertit, i dëgjuar në seancë gjyqësore.

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka pranuar qëndrimin e instancave më të ulëta edhe për zbatimin e të drejtës materiale, duke vlerësuar se në përputhje me gjendjen faktike të provuar e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme nga ka rezultuar se kërkesëpadia është e pathemeltë. Në lidhje me çështjen e plotësimit të kushteve për shuarjen e të drejtës së servitutit, të dy gjykatat mbi bazën e provave të administruara kanë dhënë arsye të qarta se në këtë rast nuk është plotësuar asnjë kusht ligjor i përcaktuar me nenin 260 të LPDTS-së, për shuarjen e të drejtës së servitutit.

I autorizuari i paditësit në revizionin e paraqitur pretendon se Gjykata e Apelit gabimisht ka zbatuar dispozitën e nenit 260 paragrafi 1 të LPDTS-së, ngase kjo dispozitë vlen vetëm në rastet kur pronari i paluajtshmërisë dominuese nuk kundërshton shuarjen e servitutit, ndërsa paditësi

në këtë rast ka kërkuar shuarjen e servitutit sipas nenit 260 paragrafi 2 të LPDTS, që ka përcaktuar se: *“Pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar mund të kërkojë shlyerjen e servitutit sendor, nëse servituti sendor nuk është më i nevojshëm për shfrytëzimin e paluajtshmërisë dominuese ose nëse në mënyrë substanciale kanë ndryshuar rrethanat. Shlyerja e servitutit duhet të regjistrohet në regjistrin e të drejtave në paluajtshme”*.

Gjykata Supreme ka trajtuar pretendimin e paditësit, mirëpo vlerëson se në këtë rast përfundimi i të dy gjykatave të instancës më të ulët i referohet plotësimit të kushteve për shuarje të servitutit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 260 paragrafi 2 të LPDTS, ndërsa fakti që është përmendur paragrafi 1 i këtij neni nuk e bënë që përfundimi të jetë i gabuar, pasi që orientimi i fakteve dhe përfundimi është nxjerr pikërisht bazuar në kërkesën e palës paditëse, përkatësisht plotësimin apo jo të kushteve për shuarjen e servitit. Ndërsa dispozita nga paragrafi 1 i nenit 260 të LPDTS, i referohet shuarjes së servitutit me deklaratën e pronarit të paluajtshmërisë dominuese, që në këtë rast është më se e qartë se pala e paditur si pronar i paluajtshmërisë dominuese nuk ka interes për shuarje të servitutit, gjë që shihet edhe nga kundërshtimet që ka përdorë në këtë proces gjyqësor.

Në këtë rast pala paditëse si pronar i ngastrës 1672 (pasurisë shërbyese nëpër të cilën kalon rruga) nuk ka kontestuar ekzistimin e servitutit për palën e paditur, por se ka kërkuar shuarjen e servitutit andaj me të drejtë gjykatat e instancës më të ulët kërkesën e kanë trajtuar në aspektin e plotësimin të kushteve për shuarje, ashtu siç është përcaktuar me dispozitën nga paragrafi 2 i nenit 260 të LPDTS. Edhe kjo gjykatë pranon qëndrimin e dhënë nga gjykatat e instancës më të ulët, kjo pasi që pala paditëse me asnjë provë nuk ka arritur të argumentoj se servituti është bërë i panevojshëm për shfrytëzimin e pronës sunduese ose të kenë pushuar arsyet për të cilat është vendosë. Madje përmes deklaramit të palëve ndërgjyqëse por edhe deklaratat e dëshmitarëve, është vërtetuar fakti se të paditurit por edhe paraardhësit e tyre, kanë shfrytëzuar dhe ende e shfrytëzojnë rrugën që kalon nëpër ngastrën e paditësit (pasurinë shërbyese), për të kaluar në paluajtshmerinë e tyre (pasurinë sunduese) dhe se nuk ekziston ndonjë rrugë alternative për të shkuar në paluajtshmerinë e të paditurve, përveç se duke shfrytëzuar paluajtshmerinë e paditësit. Një fakt i tillë është konstatuar edhe me daljen e gjykatës në vendshiqim dhe ekspertizën e gjeodezisë, përfshirë edhe dëgjimin e ekspertit në seancë gjyqësore, nga deklarimi i të cilit rezulton se nuk ka ndonjë rrugë tjetër për të kaluar në ngastrën e të paditurit përveç kalimit nëpër ngastrën e paditësit.

Kjo gjykatë vlerëson se për shkak të mungesës, përkatësisht pamundësisë së vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit, pasi që me asnjë provë nuk është arritur që të provohej fakti se të paditurit kanë rrugë alternative që mund të shfrytëzojnë paluajtshmërinë e tyre, apo që servituti të jetë bërë i panevojshëm që të paditurit ta shfrytëzojnë paluajtshmërinë e tyre, atëherë me të drejtë është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet e revizionit të autorizuarit të paditësit, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, Gjykata e Apelit ka vendosur në përputhje me gjendjen faktike dhe ka aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.

Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes sipas këtij revizioni, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, mirëpo ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, për çka edhe ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.492/2023, më 25.04.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari

Zenel Leku